



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo



NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19 NË GJENDJEN EKONOMIKE TË GAZETARËVE, KAMERAMANËVE DHE FOTOREPORTERËVE

© Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, tetor 2020

Autore: Lirika Demiri

E redaktoi: Arsim Halili

Dizajni: Tekhne Studio

Ky publikim u mbështet nga Fondacioni
i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS)

Përmbajtja

→	Shkurtesat	4
	Hyrje	5
	Metodologjia	6-8
	Situata ekonomike e punonjësve medialë gjatë COVID-19	9-20
	(Mos)Përfshirja e punonjësve medialë në Pakon Fiskale Emergjente	14-18
	Rasti i kompanisë mediale “Zëri”	18-20
	Raportimi gjatë pandemisë dhe siguria e punonjësve medialë	21-25
	Përfundimi	26
	Rekomandime	27
	Shtojca 1. Lista e personave të intervistuar	28

Shkurtesat

AGK - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës

AMPEK - Asociacioni i Mediave të Pavarura të Kosovës

IP - Inspektorati i Punës

KDI - Instituti Demokratik i Kosovës

KFOS - Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

KMShK - Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës

KPM - Komisioni i Pavarur i Mediave

MFT - Ministria e Financave dhe Transfereve

Hyrje

Pandemia COVID-19 krijoi një realitet dhe dinamikë të re në veprimtarinë e punonjësve medialë dhe gjithë sektorit të medias në Kosovë. Nga 13 marsi 2020, kur u shfaq rasti i parë me COVID-19 në vend, gazetarët, kameramanët dhe fotoreporterët, me lejen e autoriteteve qeveritare vazhduan punën në kushte të izolimit të përgjithshëm, përkundër rrezikshmërisë së infektimit nga koronavirusi. Kriza e përgjithshme ekonomike shkaktoi efekte zinxhirore në sektorin e medias duke ndikuar në uljen drastike të të hyrave nga marketingu. Si pasojë e kufizimit të përgjithshëm të lëvizjes dhe të vështirësive financiare, botuesit pezulluan shtypjen dhe shitjen e gazetave, ndërsa filluan t'a informonin publikun vetëm përmes gazetave në formatin elektronik dhe portaleve. Kjo situatë krize çoi në rëndim të gjendjes ekonomike të punonjësve medialë, duke shkaktuar largime nga puna dhe vonesa e zvogëlim të pagave nga kompanitë mediale, shpesh në kundërshtim me të drejtat e garantuara të punës. Përveç presionit financiar, gazetarët, kameramanët dhe fotoreporterët, gjatë raportimit në periudhën

e pandemisë u përballën edhe me mungesë të mjeteve mbrojtëse kundër COVID-19. Kjo gjendje, nxori në pah problemet e vazhdueshme strukturore me të cilat përballen gazetarët, fotoreporterët dhe kameramanët në Kosovë, si pozita e pasigurt financiare dhe mungesa e mbrojtjes adekuate në punë. Qëllimi i këtij raporti hulumtues është t'i paraqes pasojat e pandemisë COVID-19 në gjendjen ekonomike të punonjësve medialë, duke u përqendruar te largimet nga puna, uljet e vonesat e pagave, ndikimin e Pakos Fiskale Emergjente, vështirësitë gjatë raportimit dhe mungesën e mjeteve të nevojshme mbrojtëse kundër COVID-19. Pjesa e parë e raportit analizon situatën ekonomike të punonjësve medialë gjatë pandemisë, duke trajtuar në veçanti pasojat e pandemisë në median e shtypur dhe ndikimin e përgjithshëm të Pakos Fiskale Emergjente në sektorin e medias. Pjesa e dytë shqyrton ndryshimin e dinamikës së raportimit dhe vështirësitë e punonjësve medialë për sigurimin e mjeteve të duhura mbrojtëse kundër COVID-19.



Metodologjia




→ Metodologjia

Projekti hulumtues u zhvillua gjatë periudhës qershor-shtator të vitit 2020, pas fillimit të fazës së tretë¹ të lehtësimit të masave parandaluese kundër COVID-19 në Kosovë. Metodot kryesore hulumtuese që u përdorën për mbledhjen e të dhënave parësore ishin anketa elektronike me punonjës medialë (gazetarë, kameramanë, dhe fotoreporterë), dhe intervistat me profesionistë të fushës së medias dhe përfaqësues të institucioneve e organizatave të shoqërisë civile.

Përmes anketës elektronike, u synua grumbullimi më i gjerë i përvojave nga punonjësit medialë rreth ndikimit të pandemisë në ekonominë dhe dinamikën e tyre të punës, nga 13 marsi kur u konfirmuan rastet e para me COVID-19 në Kosovë. Anketa u përpilua përmes platformës 'Google Forms', në gjuhët shqipe dhe serbe, dhe u shpërnda me email te mbi 400 anëtarë të AGK-së dhe redaksi të medieve të ndryshme. Nga gjithsej 120 punonjës medialë që iu përgjigjën anketimit, rreth 58% prej tyre ishin gra, ndërsa 38% ishin burra. Shumica dërmuese e të anketuarve (89%) u identifikuan si shqiptarë, ndërsa të tjerët si: ashkali, egjiptas, romë, serbë dhe turq. Më shumë se gjysma (52%) e pjesëmarrësve ishin të moshës 25 dhe 34 vjeç, kurse grupmosha e dytë më e përfaqësuar (28%) e të anketuarve ishte 18 deri në 24 vjeç. Tek 66% e të anketuarve, niveli më i lartë i shkollimit ishte bachelor, ndërsa


te 32% niveli master i shkollimit. Anketa ishte anonime, por u ofroi pjesëmarrësve mundësinë që vullnetarisht t'i ndanin më gjerësisht me AGK-në përvojat e punës gjatë pandemisë.

Sa i përket llojit të medieve, shumica (54%) e të anketuarve janë punonjës në platforma mediale online, 34% prej tyre punojnë në televizion, 10% në radio, ndërsa 8% e të anketuarve punojnë në media të shtypura. Pjesa dërmuese (82%) e tyre u deklaruan se janë gazetarë, 7% kameramanë, ndërsa të tjerët redaktorë.




1. "Nesër fillon lehtësimiti i masave ndaj COVID-19" Lajmi, 31 mars, 2020, <https://lajmi.net/neser-fillon-faza-e-trete-e-lehtesimit-te-masave-ndaj-covid-19/>.

Metodologjia



Sipas nivelit të operimit gjeografik të medie, 69% e pjesëmarrësve në hulumtim thanë se punojnë në medie kombëtare, 17% në ato rajonale, ndërsa 14% në medie lokale. Pjesa dërmuese e të anketuarve (83%) punojnë në kompani mediale private, 9% prej tyre në organizata mediale jo-qeveritare dhe pothuajse aq (8%) në median e vetme publike në vend, Radio Televizionin e Kosovës. Sa i përket ndarjes së medie sipas numrit të punonjësve, 39% e të anketuarve u përgjigjën se punojnë në kompani mediale që kanë nga 10 deri në 50 punonjës, ndërsa 33% prej tyre në medie që kanë mbi 100 punonjës. 27 të anketuar apo 23%, deklaruan se punojnë në medie, të cilat kanë të punësuar më pak se 10 punëtorë, ndërsa vetëm 5% prej të anketuarve në medie me 50 deri në 100 punonjës.

Në kuadër të hulumtimit, u realizuan edhe 14 intervista – shtatë me profesionistë të fushës së medias dhe përfaqësues të institucioneve relevante e organizatave të shoqërisë civile, dhe po aq me gazetarë nga medime të ndryshme. Pjesa më e madhe e gazetarëve të përzgjedhur për intervistim raportuan në vazhdimësi gjatë pandemisë, ndërsa një prej tyre ishte larguar nga puna gjatë asaj periudhe. Megjithëse AKG-ja kontaktoi një numër më të madh të punonjësve medialë që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë, ata refuzuan të merrnin pjesë në hulumtim, ngase druanin se kjo gjë mund të ndikonte në proceset gjyqësore të iniciuara prej tyre.



Për shkak të rrethanave të shkaktuara nga pandemia, disa nga intervistat u realizuan përmes aplikacioneve për komunikim virtual, ndërsa të tjerat duke respektuar masat mbrojtëse kundër COVID-19.

Përveç zhvillimit të anketës dhe intervistave, AGK-ja i kontaktoi disa prej institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile për të kërkuar të dhëna dhe informata relevante për hulumtim. Poashtu, u konsultuan të dhëna dytësore dhe publikime ekzistuese rreth ndikimit të gjithmbarshëm të COVID-19 në Kosovë, i cili është reflektuar edhe në sektorin e medie dhe punën e punonjësve medialë.

Të dhënat e hulumtimit i referohen periudhës kohore nga 13 marsi, kur u konfirmua rasti i parë me COVID-19 në vend e deri në përfundimin e procesit të intervistimit, në fillim të muajit shtator. Anketa ishte e qasshme online për punonjësit medialë gjatë muajit korrik dhe andaj përgjigjet e të anketuarve reflektojnë përvojat e tyre nga fillimi i pandemisë në vend e deri në fund të muajit korrik. Në hulumtim, termi punonjës medialë i referohet gazetarëve, fotoreporterëve dhe kameramanëve, si kategori të përfaqësuar nga AGK-ja.



Situata ekonomike
e punonjësve
medialë gjatë
COVID-19





Situata ekonomike e punonjësve medialë gjatë COVID-19

Sektori i medieve në Kosovë nuk mbeti i izoluar nga rënia e përgjithshme ekonomike në vend si pasojë e pandemisë globale COVID-19. Sipas Ministrisë së Financave, në periudhën e izolimit (mars-maj 2020), të hyrat buxhetore të Kosovës pësuan rënie prej 28.2%, krahasuar me periudhën e njëjtë kohore të vitit paraprak 2019 ². Sipas një skenari realist për llogaritës, konsiderohet se rënia ekonomike do të mund të ndikonte që papunësia strukturore në Kosovë të rritej për 23%, ndërsa deri në fund të vitit, për 31.3% ³. Nga muaji mars, numri i punëkërkuësve të regjistruar në Agjencinë e Punësimit u shumëfishua për rreth 40 herë ⁴, duke arritur në 37,392 deri në muajin prill. Ky numër gjatë katërmujorit të parë në vitin 2019 ishte vetëm 6,882 ⁵.

Në mediet private, kriza e përgjithshme ekonomike u manifestua me ulje të menjëhershme të të hyrave nga marketingu, e si pasojë edhe me ndërprerje të shtypjes së gazetave për afat të pacaktuar, ulje të pagave dhe largime nga puna të punonjësve medialë.

Imer Mushkolaj, kryetar i Këshillit të Medieve të Shkruara të Kosovës (KMSHK), thekson se pandemia COVID-19 shkaktoi efekt zinxhiror në sektorin e medieve, duke bërë që rënia e përgjithshme ekonomike e bizneseve të reflektohet në uljen e numrit të reklamave në hapësirat mediale, e për pasojë edhe në zvogëlimin e të hyrave të medimeve gjatë kësaj periudhe. Sipas tij, ky ndikim pasqyrohet më së miri nga pezullimi i shtypjes së gazetave ditore, që prej fillimit të pandemisë në vend. “Momentalisht në Kosovë, nuk shtypet asnjë gazetë. Pra, nëse shkon sot në kioskë nuk e gjen asnjë gazetë të përditshme, prej katër sa janë shtypur dhe kanë dalë në shitje para fillimit të pandemisë” ⁶, tha Mushkolaj.

Kostoja e përgatitjes teknike, shtypjes dhe shpërndarjes, kufizimi i plotë i qarkullimit të qytetarëve dhe mbyllja e pikave të shitjes në muajt e parë të pandemisë, ndikoi që botuesit e gazetave të ndërpresin pasimin në treg të të përditshmeve: Bota Sot, Epoka e Re, Koha Ditore dhe Zëri.

2. Instituti GAP, Ndikimi i pandemisë COVID-19 në buxhedit e Kosovës, fq.10, qershor 2020, https://www.institutigap.org/documents/31153_Ndikimi%20i%20pandemis%C3%AB%20e%20Buxhet.pdf.

3. Edison Jakurti, “Ndikimi i mundshëm i COVID-19 në papunësi në Kosovë: një analizë përmes skenarëve”, S'bunker, 13 gusht, 2020, <https://sbunker.net/te/90603/ndikimi-i-mundshem-i-covid-19-ne-papunesi-ne-kosove-nje-analize-permes-skenareve/>.

4. Kjo rritje e lartë e punëkërkuësve të regjistruar mund të jetë edhe rezultat i masës 15 të Pakos Fiskale Emergjente, e cila parashihte pagesë prej 130 eurosh për qytetarët e regjistruar si punëkërkuës.

5. Instituti GAP, Ndikimi i pandemisë COVID-19 në tregun e punës, fq.7, qershor 2020, https://www.institutigap.org/documents/97205_covid_tregu_punes.pdf.

6. Imer Mushkolaj, intervistë nga AGK-ja, 3 korrik, 2020.

Drejtuesit e “Koha Ditore” vazhduan botimin e gazetës vetëm në formë elektronike duke e ofruar falas për lexuesit, derisa në fund të qershorit filloi vetëm shtypja e shtojcës së të dielës⁷. Gazetat e tjera vazhduan punën online, me gazetarët të cilët kryesisht punuan nga shtëpitë e tyre⁸. Pandemia COVID-19 rëndoi pozitën edhe ashtu të vështirë të medias së shtypur, jo vetëm në Kosovë, por në të gjithë botën. Konsiderohet se kjo situatë globale mund të shënojë fazën përfundimtare të tkurrjes së medias së shtypur, duke kërkuar një rimendim dhe ristrukturim të funksionimit të saj⁹. Dren Gërguri, ligjërues në Departamentin e Gazetarisë, në Universitetin e Prishtinës, konsideron se në Kosovë pandemia vetëm sa ka përshpejtuar dinamikën e rënies së shitjes së gazetave të shtypura, të cilat edhe para pandemisë nuk kanë pasur qëndrueshmëri financiare.

Për Flutura Kusarin, juriste e së drejtë së medias, pandemia shpërfaqti të gjitha problemet strukturore ekzistuese në fushën e gazetarisë, e sidomos pozitën e pasigurt financiare të punonjësve medialë në Kosovë. Ajo thekson se pasojat kryesore ekonomike të COVID-19 për punonjësit medialë ishin largimet nga puna dhe zvogëlimi e vonesa e pagave. “Gazetarët në Kosovë, përveçse paguhen pak dhe shpesh niveli i pagave të tyre është në shpërputhje të plotë me përfitimet e menaxherëve të mediave, gjatë kësaj periudhe më shumë se çdo herë

tjetër, janë përballur me vonesa dhe zvogëlime të pagave”¹⁰, tha Kusari.

Ndryshimi i marrëdhënies së punës dhe pagave të punonjësve medialë pas fillimit të pandemisë, reflektohet edhe në rezultatet e anketës online të AGK-së. Përderisa për periudhën para pandemisë, 22 nga 120 të anketuarit ishin përgjigjur se paga e tyre mujore ishte nga 130 deri në 250 euro, numri i tyre u rrit në 38 pas fillimit të pandemisë. Ndërsa, numri i punonjësve medialë që ishin deklaruar se u paguan mbi 250 euro, pas pandemisë është zvogëluar. Nga 24 të anketuar, të cilët thanë se para pandemisë paguheshin nga 260 deri në 350 euro, në periudhën pas pandemisë, numri i tyre ra në 20. Njëjtë u zvogëlua edhe numri i punonjësve medialë që paguheshin nga 360 deri në 500 euro, prej 35 sa ishin para pandemisë, në 30 pas saj. 21 të anketuar janë deklaruar se para pandemisë paguheshin nga 500 deri në 650 euro, ndërsa pas pandemisë, numri i tyre ra në 17. Edhe numri i atyre që paguhen më shumë se 650 euro është zvogëluar, nga 18 sa ishin para pandemisë në 15 pas saj. Këto shifra tregojnë se pandemia preku më shumë punonjësit medialë me pagat më të ulëta, duke ndikuar në rritjen e numrit të atyre që marrin pagë minimale nga 130 deri në 250 euro. Një numër i konsiderueshëm i punonjësve medialë deklaruan në anketë se zvogëlimi i pagës ishte pasojë e shkurtimit të detyruar të orarit të punës dhe vështirësive financiare të medimeve ku punojnë.


7. “ E diela me Koha Ditore sërish në duar të lexuesve” Koha Ditore, 28 qershor, 2020, https://www.koha.net/arberi/227540/e-diela-me-koha-ditore-serish-ne-duarte-lexuesve/?fbclid=IwAR3e4cMmssbjQfJ1mWhnsuZShHkrWp6gbeVaWrVOuobFATGaFGytWk3BQ_!

8. Besnik Boletini, “Pasoja e pandemisë në mediat e shkruara”, Kosova Live, qershor 2020, <https://www.kosovalive360.com/pasoja-e-pandemise-ne-mediat-e-shkruara/?fbclid=IwAR29uWqOncbyYuKBrwLvO6E3Q6VBti4-SSAwC5nrObC7okazKILaFhLzEY>

9. Roy Greenslade, “Why our newspapers might not survive the contagion of coronavirus”, The Guardian, 12 April, 2020, <https://www.theguardian.com/media/commentisfree/2020/apr/12/newsprint-coronavirus-newspapers>

10. Flutura Kusari, intervistë nga AGK-ja, 18 qershor, 2020.

Situata ekonomike e punonjësve medialë gjatë COVID-19



Përderisa 113 prej të anketuarve u përgjigjën se para pandemisë punonin me orar të plotë (40 orë në javë), ky numër u zvogëluua në 103 kur u pyetën për marrëdhënien e tyre të punës pas fillimit të pandemisë. Para pandemisë, vetëm një punonjës medial ishte deklaruar se punonte me gjysmë orari, ndërsa pas pandemisë numri u rrit në nëntë. Njëjtë, pas pandemisë u rrit edhe numri i punonjësve medialë të pavarur, nga katër sa ishte para pandemisë në gjashtë. Poashtu, dy të anketuar u deklaruan se pas fillimit të pandemisë janë të papunë, përderisa ky numër ishte zero në periudhën para pandemisë.

Niman Racaj, drejtor në Departamentin Ligjor të Komisionit të Pavarur për Media (KPM), theksoi se në bisedat e vazhdueshme me përfaqësuesit e medieve që nga fillimi

i pandemisë, ky institucion pranoi kërkesa për lirim të medieve nga pagesa e tarifës së licencës, për shkak të vështirësive financiare me të cilat u përballën gjatë pandemisë. Të njëjtën kërkesë, KPM-ja e përcolli në muajt e parë të pandemisë te Ministria e Financave dhe Transfereve, e cila menaxhon buxhetin e mbledhur nga pagesat e kësaj tarife. “Ne si institucion e kemi konsideruar këtë kërkesë si të vetmen mundësi për t’i mbështetur mediet, duke konsideruar se pagesa e tarifës së licencës në këtë kohë mund të paraqes ngarkesë financiare për to”¹¹, tha Racaj. Megjithatë, Ministria e Financave nuk e aprovoi kërkesën për lirim nga pagesa e tarifës duke iu

referuar Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, ku kjo tarifë përcaktohet si obligim ligjor për ofruesit e shërbimeve mediale¹².

11. Niman Racaj, intervistë nga AGK-ja, 14 korrik, 2020.

12. Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave, nr. 04/L-44, neni 26, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2809_neni.

Racaj shtoi se pas pranimit të përgjigjes nga Ministria, KPM-ja nuk kishte kompetenca ligjore të ndërmerre ndonjë veprim në këtë drejtim dhe se një gjë e tillë do të mund të bëhej vetëm nëse Kuvendi i Kosovës do ta ndryshonte ligjin përkatës. Për më tepër, për shkak të mungesës së Komisionit të Brendshëm të KPM-së gjatë periudhës së pandemisë, nga ky institucion nuk ishte e mundur as marrja e vendimit për pezullimin e përkohshëm të pagesës së tarifës, e cila sipas afatit të përcaktuar duhej të bëhej në muajin qershor. Sidoqoftë, Racaj tha se KPM-ja është munduar të jetë më fleksibël sa i përket këtij afati, duke e mirëkuptuar vonesën e pagesave të tarifës deri në mesin e muajit korrik. Ndër të tjera, Racaj përmendi se për shkak të vështirësive financiare gjatë pandemisë, disa televizione lokale ndërprenë transmetimin me frekuencë, për shkak se nuk ishin në gjendje ta përballonin koston e mirëmbajtjes së pajisjeve, duke vazhduar kështu vetëm me transmetim kabllor. Në mënyrë që të adresohet situata e rënduar ekonomike e medieve audiovizuele, Asociacioni i Medieve të Pavarura Elektronike të Kosovës (AMPEK), pak ditë pas fillimit të pandemisë, ia drejtoi Qeverisë së Kosovës një listë kërkesash për ndihmë financiare. Kërkesat, të cilat u hartuan para miratimit të Pakos Fiskale Emergjente, ndër të tjera, artikulonin nevojën e mbështetjes për paga të punonjësve medialë, vendosjen e moratoriumit për kredi, ndërprerjen e obligimeve tatimore ndaj shtetit, si dhe kompensimin e shpenzimeve të qirasë. Përlllogaritja e vlerës monetare të nevojshme për plotësimin e kërkesave u bazua në raportet vjetore financiare të medieve audiovizuele,

të siguruara nga KPM-ja. “Pas fillimit të pandemisë, ne jemi mobilizuar menjëherë, duke e bërë një listë me kërkesa dhe duke caktuar një takim me Qeverinë, më 16 mars. Me ndihmën e KPM-së kemi arritur të bëjmë një përlllogaritje të nevojave financiare të medieve audiovizuele, duke u bazuar në buxhetet e tyre vjetore të dorëzuara në KPM, dhe atë përlllogaritje më pas ia kemi dorëzuar qeverisë”¹³, tha Ardita Zejnullahu, drejtoreshë e AMPEK-ut. Megjithëse disa prej kërkesave të AMPEK-ut u adresuan përmes Pakos Fiskale Emergjente, Zejnullahu konsideron se do të ishte më e drejtë sikur sektorit të medieve t’i ofrohej një ndihmë më specifike, marrë parasysh rolin e rëndësishëm të këtij sektori për informim publik. Në muajin korrik, AMPEK-u realizoi edhe një takim me Qeverinë, për t’i përfshirë kërkesat e medieve audiovizuele në planin qeveritar për Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike.

Gjatë periudhës së pandemisë, mbështetje specifike për mediet dha Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), përmes krijimit të një fondi emergjent nga i cili u ofruan grante për medie private dhe organizata jo-qeveritare. Grantet emergjente synuan zbutjen e pasojave ekonomike nga rënia drastike e të hyrave nga reklamat për mediet private, duke e konsideruar të rëndësishme “ruajtjen e pluralitetit të peizazhit mediatik, sidomos gjatë kohës së izolimit kur raportimi i drejtë dhe i saktë ishte bërë edhe më i rëndësishëm”¹⁴. Nga 41 medie sa kanë aplikuar, 15 prej tyre kanë përfituar nga thirrja për grante.

13. Ardita Zejnullahu, intervistë nga AGK-ja, 17 korrik, 2020.

14. Lura Limani, koordinatore programi në KFOS, komunikim përmes emailit, 27 korrik, 2020.

(Mos)Përfshirja e punonjësve medialë në Pakon Fiskale Emergjente

Më 30 mars të vitit 2020, Qeveria miratoi Pakon Fiskale Emergjente ¹⁵, për sigurimin e ndihmës financiare afatshkurtër për menaxhim të krizës, duke subvencionuar ndërmarrjet e sektorit privat, përfituesit e skemave sociale dhe punëtorët më të prekur nga pandemia COVID-19. Ndër masat kryesore të përfshira në Pako ishin: pagesa e dyfishtë për përfituesit e skemave sociale, mbulimi shpenzimeve të pagave dhe qirasë për ndërmarrjet e sektorit privat, pagat shtesë për kategoritë e punëtorëve të ekspozuar në rrezik në sektorin publik dhe privat, mbështetja financiare për komunat, kulturën dhe qytetarët e lajmëruar si të papunë. ¹⁶

Në kuadër të Pakos Fiskale Emergjente, mediet u përfshinë në kategorinë e bizneseve, duke iu dhënë e drejta të përfitojnë nga masat 1.3, 1.10 dhe 1.14, të cilat parashihnin mbulimin e shpenzimeve të pagave të punonjësve në vlerë prej 170 euro për muajt prill dhe maj, mbulimin e vlerës së qirasë deri në 50% për këta dy muaj, sigurimin e likuiditetit financiar si dhe mbështetjen prej 130 eurosh për mediet që regjistrojnë punëtorët me kontratë të punës së paku një vjeçare gjatë periudhës emergjente të pandemisë. ¹⁷

Megjithatë, në ditët e para pas miratimit të Pakos dolën mjaft paqartësi rreth përfshirjes

së mediave, punonjësve medialë dhe mënyrës së përfitimit të tyre nga mbështetja financiare emergjente. Para miratimit të Pakos, AGK-ja ka bërë përpjekje të kontaktonte me Ministrinë e Financave dhe Transfereve (MFT) për t'u informuar rreth mbështetjes së paraparë për punonjësit medialë duke kërkuar përfshirjen e domosdoshme të gazetarëve, fotoreporterëve dhe kameramanëve, por nuk kishte pranuar ndonjë përgjigje nga MFT-ja. Pas miratimit të Pakos, AGK-ja kërkoi nga MFT-ja të bëheshin të qarta masat dhe procedurat përmes së cilave do të mund të përfitonin mediet dhe punonjësit medialë, duke e konsideruar këtë gjë thelbësore për parandalimin e rasteve të mundshme të largimeve nga puna të punonjësve medialë. ¹⁸

Sipas të dhënave të pranuar nga MFT-ja në qershor të vitit 2020, në tërësi ishin 111 kompani aktiviteti i të cilave ka të bëjë me publikimin e gazetave, transmetim televiziv, faqe portalesh dhe agjenci të lajmeve, që kanë përfituar nga pika e parë e masës 1.3, duke pranuar mbulimin e pagave në vlerë prej 170 eurosh për gjithsej 1,349 punonjës medialë, për muajt prill dhe maj. Sipas të dhënave, numri i përgjithshëm i medieve që kanë aplikuar për këtë masë ishte 123, duke lënë të kuptohet se 12 medieve u ishte refuzuar kërkesa nga MFT-ja, për përfitim prej masës 1.3. Ndërsa, 27 kompani mediale nga gjithsej 28 sa kishin aplikuar, kanë përfituar nga 130 euro të parapara sipas masës 1.14, për gjithsej 60 punonjës medialë, të cilët janë regjistruar për herë të parë me kontratë pune së paku një vjeçare nga punëdhënësi gjatë periudhës së pandemisë.

15. "Miratohet Pakoja Emergjente Fiskale, 9 milionë euro më shumë se që ishte propozuar", Koha Ditore, 30 mars, 2020, <https://www.koha.net/arberi/215483/miratohet-pakoja-emergjente-fiskale-9-milione-euro-me-shume-se-qe-ishte-propozuar/>.

16. Qeveria e Republikës së Kosovës, "Vendimi nr. 01/19", 30 mars, 2020, <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimi-i-Qeveris%C3%AB-nga-Mbledhja-e-19.pdf>.

17. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, "MFT konfirmon: punëtorët medialë janë të përfshirë në pakon emergjente", 3 prill, 2020, <http://agk-ks.org/mft-konfirmon-punetoret-medial-jane-te-perfshire-ne-pakon-emergjente/>.

18. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, "Gazetarët, kameramanët, fotoreporterët, dhe punonjësit e tjerë medialë gjithsesi të përfshihen në pakon emergjente të Qeverisë", 31 mars, 2020, <http://agk-ks.org/gazetaret-kameramanet-fotoreporteret-dhe-punonjesit-tjere-medial-gjithsesi-te-perfshihen-ne-pakon-emergjente-te-qeverise/>.

Situata ekonomike e punonjësve medialë gjatë COVID-19


Kërkesat				Aprovimet		
Masat	Kodi	Aktiviteti	Nr. i Bizneseve	Nr. Punëtorëve	Nr. i Bizneseve	Nr. i Përfituesve
3a	5813	Publikimi i gazetave	6	300	5	294
3a	6020	Aktivitete të transmetimit televiziv	47	658	44	615
3a	6312	Web portalet	47	249	41	201
3a	6391	Aktivitete të agjencive të lajmeve	23	246	21	239
Totali:			123	1453	111	1349
14	5813	Publikimi i gazetave	1	4	1	4
14	6020	Aktivitete të transmetimit televiziv	11	30	10	26
14	6312	Web portalet	7	15	7	15
14	6391	Aktivitete të agjencive të lajmeve	9	17	9	15
Totali:			28	66	27	60

Situata ekonomike e punonjësve medialë gjatë COVID-19

Nga të dhënat për masën 1.14, kuptohet që një numër i konsiderueshëm i punonjësve medialë të cilët kanë punuar pa kontrata pune përfituan nga kjo masë, duke u regjistruar si punonjës të rregullt gjatë periudhës së pandemisë. Në anketën online, shumica (84%) e punonjësve medialë të anketuar janë përgjigjur se para fillimit të pandemisë kanë pasur kontratë, 10% e tyre apo 12 punonjës janë deklaruar se nuk kanë pasur kontratë pune, derisa 6% e të anketuarve refuzuan të përgjigjeshin për këtë çështje. AGK-ja në vazhdimësi ka theksuar ¹⁹ problemin e mungesës së kontratave të punës për punonjësit medialë, duke vlerësuar se kjo gjë paraqet shkelje të Ligjit të Punës dhe krijon gjendje të pasigurisë financiare për punonjësit medialë.

Në anketë, 43% e 120 punonjësve u deklaruan se kanë pranuar mbështetje nga Pakoja Emergjente Fiskale, 55 (46%) prej tyre thanë se nuk kanë përfituar në asnjë formë nga Pakoja, ndërsa të tjerët u përgjigjën se përfitoi punëdhënësi. Forma kryesore e ndihmës së pranuar ishte kompensimi i pagës në vlerë prej 170 eurosh i përcaktuar sipas masës 1.3 të Pakos.

Njohës të fushës së medias konsiderojnë se kjo formë e mbështetjes nuk ishte e mjaftueshme për punonjësit medialë gjatë periudhës së pandemisë. Flutura Kusari, theksoi se në muajt e parë pas fillimit të pandemisë u identifikuan raste kur mbulimi i pagave në vlerë prej 170 eurosh, ndikoi që punonjësit medialë të pranojnë pagën mujore të zvogëluar për po atë vlerë, me arsyetimin e punëdhënësve se pjesa e mbetur do t'i kompensohej nga Qeveria ²⁰. Kjo çështje bëhet edhe më shqetësuese kur dihet se edhe për shkak të procesit të ndërrimit të qeverive, pati vonesa në ekzekutimin e pagesave të parapara në Pako, të cilat u finalizuan vetëm në javën e dytë të muajit gusht ²¹. Sipas një hulumtimi të realizuar nga KDI-ja rreth realizimit të Pakos Emergjente, deri më 17 korrik, Qeveria e Kosovës ekzekutoi vetëm 45% të shumës së përgjithshme të Pakos. Në veçanti, deri në atë kohë, masa 1.3 ishte realizuar vetëm 42%, ndërsa 31% masa 1.14 ²².



19. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, Treguesit për nivelin e lirisë së medieve dhe sigurisë së gazetarëve 2018, fq.7, dhjetor 2018, <http://agk-ks.org/wp-content/uploads/2018/12/Treguesit-e-nivelit-te-lirise-se-mediave-dhe-sigurise-se-gazetareve-Kosova-2018.pdf>.

20. Kusari, in Flutura tervistë nga AGK-ja, Prishtinë, 18 qershor, 2020.

21. Ministria e Transfereve dhe Financave, "Ministria e Financave njofton qytetarët dhe bizneset se ka ekzekutuar grupin e parë të pagesave për masën 3 (a) të pakos fiskale emergjente", 10 gusht, 2020, <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,2,955>.


22. Instituti Demokratik i Kosovës, Pakoja Fiskale Emergjente: Analizë e Shkurtër, fq.14, 2020, <http://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2020/08/50-Analiz%C3%AB-e-Shkurt%C3%ABr-e-Pakos-Fiskale-Emergjente-ALB-O2.pdf>.

Situata ekonomike e punonjësve medialë gjatë COVID-19

Kusari po ashtu vlerësoi se duke marrë parasysh raportimin e vazhdueshëm në pandemi ku gazetarët, kameramanët dhe fotoreportetët rrezikuan drejtpërdrejtë shëndetin e tyre, ata ishte dashur të përfshihen në Pako në kategorinë e punëtorëve esenciale, sikurse stafi mjekësor, ai i Policisë, FSK-së, e Doganës, të cilët kanë pranuar pagesë shtesë për punën gjatë muajve të izolimit. “Aq shumë kanë qenë [gazetarët] të ekspozuar ndaj infektimit, sa që nuk ka logjikë të shëndoshë që do të mund ta arsyetonte pse gazetarët nuk kanë hyrë në kuadër të punëtorëve esenciale”, tha Kusari. I pyetur për këtë gjë, kryeministri në atë kohë, Albin Kurti ishte deklaruar²³ se do të konsiderohej mundësia për përfshirjen e punonjësve medialë si punëtorë esenciale në Pakot e ardhshme të planifikuara, çfarë nuk ka ndodhur edhe për shkak të zhvillimeve politike që pasuan.

Në anketën online të AGK-së, pjesa dërmuese e pjesëmarrësve (72%) u pajtuan plotësisht se punonjësit medialë të cilët punuan gjatë pandemisë do të duhej të përfshiheshin në Pakon Fiskale Emergjente si punëtorë esenciale; 10% prej tyre u pajtuan pjesërisht, ndërsa 12%

nuk u pajtuan fare me këtë vlerësim. Gazetari Bujar Vitija nga gazeta elektronike Shneta, i cili në vazhdimësi raportoi nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës gjatë pandemisë, tha se punonjësit medialë, veçanërisht ata që punuan në teren, është dashur medoemos të përfshihen në kategorinë e punëtorëve të rrezikuar. “Një gazetar që merr lajme te Klinika Infektive, ose shkon në një komunë vatër të virusit dhe ka kontakt me persona të infektuar, është në rrezik të drejtpërdrejtë. Po flasim për një situatë ku punëtorët medialë janë të rrezikuar sepse ushtrojnë profesionin e tyre për t’i informuar qytetarët”²⁴, shtoi Vitija.



■ Pajtohen plotësisht **■** Pajtohen pjesërisht **■** Nuk pajtohen fare

“Punonjësit medialë të cilët punuan gjatë pandemisë do të duhej të përfshiheshin në Pakon Fiskale Emergjente si punëtorë esenciale.”

23. Kurti e pranon se s’ka mbështetje për gazetarët në pakon emergjente të qeverisë”, Lajmi, 10 prill, 2020, <https://lajmi.net/kurti-e-pranon-se-ska-mbeshtetje-per-gazetaret-ne-pakon-emergjente-te-qeverise/>.

24. Bujar Vitija, intervistë nga AGK-ja, 10 korrik, 2020.

Gjatë procesit të dhënies së mbështetjes financiare nga Pakoja, disa medie reagueshan²⁵ duke cilësuar se MTF-ja kishte tendencë për trajtim të pabarabartë të tyre. Imer Mushkolaj, kryetar i KMSHK-së tha se “disa nga anëtarët tonë janë ankuar publikisht që nuk e kanë pranuar ende mbështetjen financiare. Kjo mund të ketë ndodhur edhe për shkak të procesit të gjatë të verifikimit. Megjithatë, në asnjë formë nuk duhet të ketë qasje selektive karshi ndihmës që iu ofrohet medieeve, pavarësisht qëndrimeve kritike që ato mund të kenë kundrejt qeverisë”²⁶. Për Flutura Kusarin, kjo situatë përbën tendencë për “disiplinim të mediave përmes përdorimit të parasë publike”²⁷. Të pyetur për këtë gjë në anketën online, nga 120 punonjës medialë, 37 % pajtohen plotësisht se jo të gjitha mediet janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe të paanshme gjatë procesit të përzgjedhjes për përfitim nga Pakoja; 17% e tyre pajtohen pjesërisht me këtë vlerësim, ndërsa 24 % nuk kanë mendim rreth kësaj çështjeje. Në anën tjetër, 8% e të anketuarve pajtohen, derisa 15% e tyre nuk pajtohen aspak me një vlerësim të tillë.

Rasti i kompanisë mediale “Zëri”

Ndër rastet më shqetësuese të shkeljes së të drejtave të punës dhe të pasojave ekonomike në sektorin e medias gjatë pandemisë COVID-19, ishte largimi nga puna i mbi 20 punonjësve medialë të kompanisë “Zëri”. Në fund të muajit mars, AGK-ja u informua nga punonjësit e larguar se pa asnjë paralajmërim dhe në kundërshtim me afatet ligjore të përcaktuara me Ligjin e Punës²⁸, u ishte ndërprerë kontrata e punës nga punëdhënësi. AGK-ja ka reaguar ndaj këtij rasti²⁹ duke e konsideruar si “arbitrar dhe të papranueshëm” dhe ka kërkuar nga Inspektorati i Punës ta shqyrtonte në afat sa më të shkurtër kohor.

Për Flutura Kusarin, ky rast paraqet rastin më të rëndë të ndikimit ekonomik të COVID-19, tek punonjësit medialë në Kosovë. “Ne kemi parë raste, siç është ai i “Zërit”, ku një numër i madh i gazetarëve, përfshirë dy gra shtatzëna, janë larguar nga puna dhe kjo është pasoja e më e rëndë ekonomike që mund t’i ndodhë një gazetari gjatë kësaj krize”³⁰, tha ajo.

25. Berat Buzhala, “Sqarim për rreth 150 punëtorë të Gazetës Express dhe Televizionit 7, dhe për publikun e gjerë”, Facebook, 11 maj, 2020, <https://www.facebook.com/berat.buzhala/posts/10157074402701479>.

26. Imer Mushkolaj, intervistë nga AGK-ja, 3 korrik, 2020.

27. Flutura Kusari, intervistë nga AGK-ja, 18 qershor, 2020.

28. Ligji i Punës, nr. 03/L-212, neni 71, <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735>.

29. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, “Plotësisht i papranueshëm largimi i punonjësve medialë nga gazeta ‘Zëri’”, 2 prill, 2020, <http://agk-ks.org/agk-plotesisht-i-papranueshem-largimi-i-punonjesve-medial-nga-gazeta-zeri/>.

30. Flutura Kusari, intervistë nga AGK-ja, 18 qershor, 2020.

Situata ekonomike e punonjësve medialë gjatë COVID-19

Një gazetare, e cila kërkoi të mbetej anonime, që ishte pjesë e kompanisë Zëri nga marsi i vitit 2019, tregoi se njoftimin për largim nga puna e kishte pranuar përmes postës elektronike, vetëm dy ditë para se t'i shkëputej marrëdhënia e punës, njëjtë si edhe kolegët e saj³¹. Ndonëse kontratën e punës e kishte deri në muajin dhjetor të vitit 2020, ajo u largua nga puna me arsyetimin e punëdhënësit se pandemia COVID-19 vështirësoi situatën financiare edhe ashtu të rënduar të kompanisë mediale “Zëri”. “Tani së fundi, me përhapjen e koronavirusit dhe vendosjen e masave emergjente shëndetësore, kur ndërpritet edhe shpërndarja e gazetës, kemi arritur në përfundim se duhet të mbyllim disa nga pozitat e punës”, thuhet në emailin dërguar punëtorëve të larguar nga pronarët e mediumit. Ajo rrëfen se edhe më herët punëdhënësi nuk u ishte përmbajtur obligimeve të kontratës, duke mos i paguar rrogat me rregull.

Përmes AGK-së, në fillim të muajit prill, punonjësit e larguar, të cilët punonin në sektorë të ndryshëm të kompanisë “Zëri”, pranuan ndihmë juridike nga këshilltari ligjor në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI), Florent

Spahija, për përpilimin e ankesave drejtuar punëdhënësit. Pas ankesave të dërguara për shkelje të Ligjit të Punës, dy gazetaret shtatzëna u rikthyen në vendin e punës nga kompania “Zëri”, ndërsa punonjësve tjerë u është njohur e drejta për një pagë shtesë³². “Janë miratuar vetëm ankesat e dy gazetareve të cilat ishin shtatzëna, pasi ligji e ndalon një largim të tillë nga puna të punëtorëve shtatzëna që kanë kontratë pune”, tha Spahija. Sipas tij, në mesin e të larguarve, ishin edhe gazetarë të cilët kishin punuar për më shumë se dhjetë vjet në mediumin “Zëri”, duke fituar kështu të drejtën për kontratë pune për periudhë të pacaktuar³³, e të cilët nuk janë kthyer në vendin e punës pas ankesave të parashtruara.

Tetë nga punonjësit e larguar, me mbështetje ligjore të KDI-së³⁴ iniciuan padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, duke konsideruar se vendimi i punëdhënësit është i kundërligjshëm. Ata kërkojnë kthim në vendin e punës dhe respektim të kontratave që kanë pasur. Që prej muajit prill kur ishte iniciuar padia, Gjykata Themelore ende nuk ka thirrur asnjë seancë dhe rasti nuk ka filluar të trajtohet³⁵.

31. Anonim, intervistë nga AGK-ja, 17 gusht, 2020.

32. Florent Spahija, intervistë nga AGK-ja, 6 korrik, 2020.

33. Ligji i Punës, nr. 03/L-212, neni 10, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735>.

34. Institutin Demokratik i Kosovës, Përfitimet e punëtorëve nga pakoja emergjente, fq. 7, prill 2020, <http://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2020/05/P%C3%ABrfitimet-e-pun%C3%ABtor%C3%ABve-nga-pakoja-emergjente.pdf>.

35. Florent Spahija, intervistë nga AGK-ja, 6 korrik, 2020.

Situata ekonomike e punonjësve medialë gjatë COVID-19

Të njëjtit punonjës dërguan kërkesë për shqyrtim të rastit edhe në institucionin e Inspektoratit të Punës. Valon Leci, drejtor i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, njëherësh ushtrues detyre i kryeinspektorit në kohën e fillimit të pandemisë, konfirmoi se Inspektorati i Punës pranoi ankesat e disa punonjësve medialë ndaj një kompanie mediale në lidhje me largim nga puna dhe shkelje të së drejtës së tyre në paga³⁶. “Inspektorati inicoi proces inspektues në atë media dhe do të konstatojë nëse ka shkelje. Raporti dhe vendimi zyrtar do të nxirret nga inspektori bartës i lëndës”, tha Leci. Ai theksoi se rritja e vëllimit të punës së këtij institucioni për shkak të pandemisë, në njërën anë, dhe numri i vogël i inspektorëve, në anën tjetër, mund të vonojnë trajtimin e këtij rasti pasi, sipas tij, rastet më me prioritet konsiderohen ato që kanë të bëjnë me shëndetin e punëtorëve në punë.

Në fillim të muajit shtator, AGK-ja e kontaktoi edhe kryeinspektorin, Ekrem Kastrati, i cili përmes emailit u përgjigj se “ende nuk është marrë vendimi rreth këtij rasti, lënda është në procedurë, në shkallë të parë”³⁷.

Sipas tij, vendimi pritet të merret brenda muajit shtator, megjithatë nuk dha më shumë informata për rastin. Për AGK-në është shqetësues fakti që edhe pas më shumë se pesë muajsh prej se janë larguar punonjësit medialë nga puna, Inspektoriati i Punës nuk ka marrë një vendim përfundimtar për këtë rast.

36. Valon Leci, intervistë nga AGK-ja, 2 korrik, 2020.

37. Ekrem Kastrati, komunikim përmes emailit, 10 shtator, 2020.



Raportimi gjatë
pandemisë
dhe siguria e
punonjësve
medialë





Raportimi gjatë pandemisë dhe siguria e punonjësve medialë

Vendimi i qeverisë i miratuar në muajin mars për ndalimin e qarkullimit të qytetarëve³⁸, nuk përfshiu edhe punonjësit medialë, të cilëve iu lejua vazhdimi i lirshëm i aktivitetit të tyre profesional gjatë gjithë periudhës së izolimit, duke iu kërkuar vetëm mbajtja e kartelave të tyre identifikuese të punës³⁹. Kjo mundësoi që gazetarët dhe punonjësit e tjerë medialë të raportnin në vazhdimësi, duke mbajtur qytetarët të informuar lidhur me zhvillimet e pandemisë dhe ato politike në vend dhe më gjerë, por në të njëjtën kohë duke iu ekspozuar rrezikut më të madh të infektimit me COVID-19.

Për Flutura Kusarin, raportimi i gazetarëve që nga fillimi i pandemisë ishte cilësor, sidomos kur merren parasysh kushtet në të cilat punuan gjatë asaj periudhe dhe kushtet e përgjithshme në sektorin e medias në Kosovë. “Ka qenë raportim shembullor me ndonjë përjashtim të izoluar. Mediet për aq sa ka qenë e mundur e kanë përmbushur përgjegjësinë e tyre

kryesore për konfirmim të lajmeve”⁴⁰, tha ajo. I të njëjtit mendim është edhe Dren Gërguri, ligjërues në Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, i cili gjatë pandemisë përcolli skenën mediale në Kosovë dhe rajon, veçanërisht dukurinë e lajmeve të rreme⁴¹. Ai konsideron se, “mediet kryesore përgjithësisht kanë qenë korrekte. Ka pasur dezinformata të shpërndara në rrjete sociale kryesisht nga faqe të paverifikuara, por e mira ka qenë që raportimi i gazetarëve ishte i saktë. Ata/o nuk janë ngutur të japin informacionin, duke e pasur të qartë efektin që mund ta ketë një informacion i gabuar në ato rrethana. Andaj, kjo periudhë ka shërbyer për t’u kuptuar roli i rëndësishëm i gazetarëve në shoqëri”⁴². Gjatë kësaj krize shëndetësore, gazetaria e pavarur dhe profesionale në të gjithë botën u cilësua esenciale⁴³ në luftimin e përhapjes së virusit dhe asaj që është quajtur “disinfodemi” – shpërndarja e dezinformatave në lidhje me pandeminë – përmes raportimit të informatave shkencore e të verifikuara.

38. Qeveria e Republikës së Kosovës, “Vendimi nr. 01/15”, 23 mars, <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-15-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs.pdf>.

39. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, “Gazetarëve dhe punonjësve tjerë medialë nuk u kufizohet lëvizja, me vete ta kenë ID-në e punës”, 24 mars, 2020, <http://agk-ks.org/gazetareve-dhe-punonjesve-tjere-medial-nuk-u-kufizohet-levizja-me-vete-ta-kene-id-ne-e-punes/>.

40. Flutura Kusari, intervistë nga AGK-ja, 18 qershor, 2020.

41. Dren Gërguri, “Mediat në Kosovë gjatë periudhës së COVID-19”, Portalb, 29 maj, 2020 <https://portalb.mk/686503-media-ne-kosove-gjate-periudhes-se-covid-19/>.

42. Dren Gërguri, intervistë nga AGK-ja, 23 korrik, 2020.

43. Open Society Foundations, “How COVID-19 Threatens Independent Journalism”, qershor, 2020, https://www.opensocietyfoundations.org/explainers/how-covid-19-threatens-independent-journalism?utm_medium=referral&utm_source=facebook.com&utm_



Fotografia: Ridvan Slivova

Jehona Zhitia, gazetare e RTK-së, e cila për një periudhë të gjatë kohore ka përcjellë sektorin e shëndetësisë, njëherësh raportuese e parë nga hapësirat e brendshme të Klinikës Infektive të QKUK-së gjatë krizës së COVID-19, tregon se pandemia ishte një situatë e re dhe e panjohur gjatë përvojës së saj si gazetare. Duke punuar me orar të zgjatur që nga fillimi i muajit mars, Zhitia raportoi gjatë tërë kohës nga hapësirat QKUK-së ku trajtoheshin pacientët me COVID-19 apo kryheshin analizat laboratorike. Për pasojë, edhe vetë u infektua me koronavirus, në muajin gusht. Zhitia theksoi mungesën e mjeteve të nevojshme mbrojtëse për punonjësit medialë, sidomos për ata të cilët vizitonin vatrat pandemike dhe kishin nevojë për disa palë mjetesh mbrojtëse gjatë një dite pune. “Nga fillimi i pandemisë, gazetarë nga mediume të ndryshme kemi diskutuar se si t’ia bëjmë për t’i siguruar mjetet mbrojtëse, dhe secili e kemi pasur shqetësimin e njëjtë: se do të detyrohemi t’i siguronim vetë. Pas një kohe, në

RTK ka filluar t’i sigurojë redaksia, por jo në sasi të mjaftueshme. Kjo ka qenë problematike”⁴⁴, tha Zhitia.

Sipas saj, edhe më e vështirë ishte sigurimi i veshjeve mbrojtëse të nevojshme për të hyrë në klinikat e QKUK-së. Përveç herës së parë kur veshja mbrojtëse i ishte siguruar nga Klinika Infektive, Zhitia tregon se herëve të tjera ishte e detyruar t’i siguronte përmes rrugëve jozyrtare. “Diku rreth 30 euro kushtonin ato veshjet e përgjithshme, kominoshe, kapela, xhami mbrojtës, dorëzat, maska, që do të thotë se për mua, kameramanin dhe inxhinierin që realizonte transmetimin e drejtpërdrejtë, kapte koston rreth 100 euro. Asnjëri nuk ishim në një gjendje komode financiare që t’i blinim dhe ky nuk ishte obligim i yni”⁴⁵, tha Zhitia derisa tregoi vështirësitë për sigurimin e tyre përmes lidhjeve joformale.

44. Jehona Zhitia, intervistë nga AGK-ja, 07 shtator, 2020.


45. Ibid.

Raportimi gjatë pandemisë dhe siguria e punonjësve medialë

Të njëjtën përvojë gjatë raportimit nga hapësirat e QKUK-së kishte edhe gazetarja e Express, Gentiana Hasani, e cila konsideron se institucionet përkatëse shëndetësore apo redaksitë e medimeve ishte dashur t'i siguronin mjete mbrojtëse për punonjësit medialë. "Për të hyrë në klinikat ku janë të shtrirë pacientët me COVID-19 duhet t'i blesh të gjitha pajisjet mbrojtëse vetë. Ekziston vullneti por jo edhe mundësitë financiare për gazetarët që të futen brenda klinikave dhe ta përcjellin situatën reale tek publiku " ⁴⁶, tha Hasani. Ajo theksoi se mediumi ku punon është arsyetuar se për shkak të vështirësive më të mëdha financiare gjatë pandemisë, nuk ishte në gjendje t'i kompensonte të gjitha shpenzimet e punonjësve medialë për sigurimin e mjeteve të nevojshme mbrojtëse gjatë raportimit.

Përvojë më të mirë në këtë aspekt pati Adelina Ahmeti ⁴⁷, gazetare në BIRN Kosova, e cila tha se mediumi ku punon ua siguroi me kohë të gjitha mjetet mbrojtëse punonjësve medialë, përfshirë edhe rrobat mbrojtëse të nevojshme për të raportuar nga hapësirat me rrezikshmëri të lartë infektimi, si klinikat e QKUK-së. "Prej fillimit jemi pajisë me rrobat mbrojtëse të cilat janë të domosdoshme në Klinikë Infektive apo objektet e tjera ku ka të infektuar. Kanë qenë shumë të nevojshme kur kemi dalë në terren, dhe nuk e kemi pasur atë problem pasi të gjitha [mjetet mbrojtëse] janë siguruar nga fillimi", tregoi Ahmeti.

Në anketën online, 77% e punonjësve medialë deklaruan se punëdhënësi u siguroi dezinfektues për duar, 68% prej tyre thanë se u janë siguruar maska mbrojtëse për fytyrë, dhe pothuajse po aq (67%) u përgjigjën se pranuan dorëza për një përdorim nga punëdhënësi. Po ashtu, pak më shumë se gjysma e të anketuarve (54%) u përgjigjën se ishte bërë dezinfektimi i ambienteve të punës. Në anën tjetër, 10% e të anketuarve u deklaruan se nuk u ishte siguruar asnjë mjet mbrojtës nga punëdhënësit dhe po aq thanë se u pajisën vetë me mjetet e nevojshme mbrojtëse për raportim gjatë pandemisë, derisa 9% e tyre thanë se nuk patën fare mjete mbrojtëse.



46. Gentiana Hasani, intervistë nga AGK-ja, 18 gusht, 2020.

47. Adelina Ahmeti, intervistë nga AGK-ja, 16 korrik, 2020.

Si mënyrë të zvogëlimit të rrezikut për infektim nga COVID-19, gazetarët praktikuan edhe zhvillimin e intervistave dhe pranimin e informacionit nga distanca, përmes mjeteve të telekomunikimit. Në anketën online, 53% e punonjësve medialë deklaruan se e përdorën këtë formë të punës gjatë pandemisë, në mënyrë që t'i shmangin kontaktet e shpeshta fizike. Fitim Gashi, gazetar në Grupin KOHA, i cili për dy javët e para të pandemisë punoi nga shtëpia, tregoi se gjatë asaj kohe doemos nevojitej një riororganizim i punës së përditshme. “Kontaktimi i palëve është bërë kryesisht përmes emailit, telefonit, dhe platformave të tjera komunikuese. Edhe përcjellja e punës së Kuvendit është bërë vetëm online duke na pamundësuar marrjen e drejtpërdrejtë të qëndrimeve të deputetëve. Në shumë raste, në hapësirat ku janë zhvilluar konferencat nuk janë siguruar masat mbrojtëse dhe ka pasur mbipopullim të sallave ku duhej të ishin prezentë gazetarët”⁴⁸, tha Gashi, i cili përcolli zhvillimet politike në vend gjatë asaj periudhe. Edhe Fatmir Menekshe, gazetar në radion lokale “Romano Avazo” në Prizren, tha se si masë parandaluese kundër COVID-19, shumicën e emisioneve i kanë realizuar përmes telefonatave: “Përveç emisioneve të fundit kur u liruan masat të cilat kemi mundur t'i realizojmë në studio bashkë me të ftuar, pjesa tjetër më e madhe e emisioneve është kryer përmes telefonatave”⁴⁹.


Nga fillimi i pandemisë në vend, në muajin mars, AGK-ja përmes dy donacioneve shpërndau mjete mbrojtëse si, maska, dezinfektues dhe dorëza, për më shumë se 500 punonjës medialë. Donacioni i parë⁵⁰ i dhuruar nga KFOS-i u shpërndau në mesin e muajit prill me

48. Fitim Gashi, intervistë nga AGK-ja, 30 korrik, 2020.

49. Fatmir Menekshe, intervistë nga AGK-ja, 27 korrik, 2020.

50. “AGK do të shpërndajë materiale mbrojtëse për 313 gazetarë, kameramanë dhe fotoreporterë të terrenit”, Kallxo, 14 prill, 2020, <https://kallxo.com/lajm/agk-do-te-shperndaje-materiale-mbrojtese-per-313-gazetare-kameramane-dhe-fotoreportere-te-terrenit/>.

qëllim të ofrimit të ndihmës së menjëhershme me mjete mbrojtëse për punonjësit medialë, të cilët punonin në teren. Nga ky donacion përfituan rreth 36 medie lokale dhe kombëtare në të gjithë vendin. Donacioni i dytë⁵¹ i dhënë nga Shoqata e Sigurimeve të Kosovës (ShSK), u shpërndau nga AGK-ja në muajin gusht për rreth 30 medie kombëtare dhe lokale që operojnë në Prishtinë. Përmes njoftimit publik, para shpërndarjes së donacioneve, AGK-ja informoi të gjitha mediet për mundësinë e përfitimit të mjeteve mbrojtëse, duke u siguruar që ato të shpërndahen në bazë të nevojave të punonjësve medialë të terrenit në secilin medium. Sipas të dhënave nga anketa online, përveç ekspozimit ndaj rrezikut për infektim, puna gjatë periudhës së pandemisë rëndoi edhe shëndetin mendor të punonjësve medialë. 19% e pjesëmarrësve në anketim u deklaruan se raportimi gjatë pandemisë rëndoi shumë gjendjen e shëndetit mendor të tyre dhe 46% prej tyre thanë se përjetuan pak rëndim të shëndetit mendor gjatë kësaj periudhe, duke bërë që gjithsej 65% e të anketuarve të kenë përjetuar rëndim të shëndetit mendor për shkak të raportimit gjatë pandemisë. Në anën tjetër, 30% e punonjësve medialë u përgjigjën se puna gjatë pandemisë nuk ndikoi në shëndetin e tyre mendorë, ndërsa pjesa e mbetur e të anketuarve 5% nuk preferuan të përgjigjeshin për këtë çështje.



51. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, “AGK së bashku me ShSK-në ndajnë 15 mijë maska dhe mbi 3 mijë e 300 dezinfektues për gazetarë, kameramanë dhe fotoreporterë”, 7 gusht, 2020, <http://agk-ks.org/agk-se-bashku-me-shsk-ne-ndajne-15-mije-mask-a-dhe-mbi-3-mije-e-300-dezinfektues-per-gazetare-kameramane-dhe-fotoreportere/>.

Përfundimi

Kriza ekonomike në Kosovë e shkaktuar nga pandemia COVID-19 ndikoi në mënyrë zinxhirore në sektorin e medias. Rënia e përgjithshme e aktivitetit ekonomik në vend nga mesi i muajit mars, çoi në uljen e të hyrave të medieve nga marketingu, duke rënduar gjendjen e tyre financiare. Kjo situatë u manifestua me ndalim të botimit të gazetave të përditshme, largim të punonjësve medialë nga puna, zvogëlim të pagave e vonesa në dhënien e tyre, duke shpërfaqur në tërësi problemet ekzistuese me të cilat përballlet sektori i medias në vend.

Largimi nga puna i mbi 20 punonjësve medialë nga kompania mediale “Zëri” ishte ndër rastet më ilustruese dhe më të rënda të ndikimit të pandemisë COVID-19 në ekonominë e punonjësve medialë. Shkëputja e kontratave të tyre të punës pa njoftim paraprak, në kundërshtim me Ligjin e Punës, me arsyetimin e kompanisë mediale se pandemia ka vështirësuar gjendjen financiare, përbën shkelje të të drejtave të punës të këtyre punonjësve medialë. Fakti se edhe pas më shumë se pesë muajve, Inspektorati i Punës nuk ka bërë shqyrtimin përfundimtar të këtij rasti, tregon se shkelja e të drejtave të punonjësve medialë nuk trajtohet me prioritet nga institucionet relevante në vend.

Në anën tjetër, Pakoja Fiskale Emergjente, megjithëse i përfshiu mediumet, si përfituese

në disa prej masave afatshkurta, nuk i cilësoi punonjësit medialë të cilët punuan gjatë periudhës së izolimit si punëtorë esenciale, duke mos u dhënë mbështetje financiare shtesë sikurse disa prej kategorive tjera të punëtorëve, përkundër ekspozimit të tyre ndaj rrezikut për infektim. Për më tepër, vonesat në shpërndarjen e mjeteve financiare për mbulimin e një pjese të pagave, bënë që shumë punonjës medialë të marrin paga të zvogëluara, me arsytimin nga punëdhënësit se pjesa e mbetur do t’i kompensohej nga mbështetja qeveritare.

Përveç ndikimit në ekonominë e punonjësve medialë, pandemia COVID-19 ndryshoi edhe dinamikën e punës së medieve. Shumë nga emisionet dhe kontaktet për qasje në informacion u zhvilluan përmes platformave online, në përpjekje për t’i respektuar masat e kërkuara të distancimit fizik. Raportimi nga vatrat e pandemisë i ekspozoi gazetarët në rrezik të drejtpërdrejtë të infektimit, duke i detyruar që shpesh të përballëshin me mungesë të mjeteve të nevojshme mbrojtëse nga pandemia. Gjatë periudhës së karantinimit, derisa shumica e aktiviteteve shoqërore u pezulluan, puna e punonjësve medialë dëshmoi se raportimi i drejtë dhe i saktë është edhe më i rëndësishëm në kohë krizash, si kjo me COVID-19.

Rekomandime

- Inspektoriati i Punës duhet të prioritizojë monitorimin dhe evidentimin e shkeljeve të të drejtave të punës së gazetarëve, kameramanëve dhe fotoreporterëve. Në veçanti, Inspektorati i Punës duhet të shqyrtojë sa më parë të gjitha rastet e shkeljes së të drejtave të punës së punonjësve medialë gjatë pandemisë COVID-19.
- Kompanitë mediale duhet t'i respektojnë të gjitha obligimet e tyre dhe të drejtat e punës së gazetarëve, kameramanëve, dhe fotoreporterëve të përcaktuara me Ligjin e Punës, si pagën mujore, orarin e punës, kohëzgjatjen e kontratës, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve medialë, dhe ofrimin e sigurisë në vendin e punë. Gjatë pandemisë COVID-19, kompanitë mediale duhet t'i sigurojnë të gjitha mjetet e nevojshme mbrojtëse kundër koronavirusit, për gazetarët, fotoreporterët dhe kameramanët, të cilët raportojnë gjatë kësaj periudhe.
- Gjykata Themelore e Prishtinës duhet të iniciojë sa më parë seancat për shqyrtimin e padive të dorëzuara nga punonjësit medialë për largim nga puna gjatë pandemisë.
- Gazetarët, kameramanët dhe fotoreporterët duhet t'i përdorin të gjithë mekanizmat ekzistues si, Inspektorati i Punës, Avokati i Popullit, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, dhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, për raportimin e shkeljes së të drejtave të punës.

Shtojca 1. Lista e personave të intervistuar

Emri dhe mbiemri	Pozita/ organizata	Data e intervistës
Adelina Ahmeti	Gazetare/ BIRN	16.07.2020
Anonim	Gazetare/ Zëri	17.08.2020
Ardita Zejnullahu	AMPEK/ Drejtoreshë	17.07.2020
Bujar Vitia	Gazetar/ Shneta	10.07.2020
Dren Gërguri	Departamenti i Gazetarisë, UP/ Asistent	23.07.2020
Fatmir Menekshe	Gazetar/ Radio Romano Avazo	27.07.2020
Fitim Gashi	Gazetar/ Grupi KOHA	30.07.2020
Florent Spahija	KDI/ Zyrtar ligjor	06.07.2020
Flutura Kusari	Juriste e medias / ECPMF	18.06.2020
Gentiana Hasani	Gazetare/ T7	18.08.2020
Imer Mushkolaj	KMShK/ Drejtor	03.07.2020
Jehona Zhitia	Gazetare/ RTK	07.09.2020
Niman Racaj	KPM/ Drejtor i Departamentit Ligjor	14.07.2020
Valon Leci	Drejtor i Departamentit të Shërbimeve të Përgjithshme dhe Financave/ Inspektorati i Punës	02.07.2020

